

KUSHTET

10 VJET GARANCI "NO BURN IN" PËR TELEVIZORËT SAMSUNG

1.Ky promocion vlen për pajisjet e blera në periudhën nga data 01.01.2019 deri në 31.03.2019 dhe kjo vetëm për blerjen e televizorëve të rinj,* të cilët janë paraqitur shprehimisht në faqen e internetit:

www.samsung.com/al/offer/samsung-10-vjet-garanci

**Si pajisje "të reja" konsiderohen edhe pajisjet e papërdorura të ekspozimit dhe pajisjet në shitje.*

2.Për të përfituar garancinë "No Burn in" në afatin prej 10 vjetësh, detajet për pajisjet duhet të regjistrohen online në adresën e internetit:

www.samsung.com/al/offer/samsung-10-vjet-garanci

Numri i telefonit për mbështetjen ndaj klientit në bazë të çmimit të thirrjes lokale për rrjetin fiks dhe celular: 045 620 202

3.Për të fituar të drejtën për garanci 10 vjeçare "No Burn in", pajisja me të cilën lidhet garancia duhet të jetë regjistruar online (siç u tha edhe më lart sipas pikës 2.) jo më vonë 60 ditë nga data e lëshimit të faturës së blerjes së kësaj pajisje.

4.Pas regjistrimit, konsumatorit do t'i dërgohet nëpërmjet postës elektronike ose nëpërmjet postës në adresën e banesës (sipas zgjedhjes së vetë konsumatorit), një njoftim mbi regjistrimin dhe fleta e Garancisë 10 vjeçare "No Burn in" me numrin serial të pajisjes së regjistruar.

5.Fletëgarancia për garanci dhjetëvjeçare dhe fatura për blerjen e pajisjes me të cilën lidhet garancia, është e nevojshme të ruhet gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kësaj garancie.

6.Garancia 10 vjeçare, e cila është objekt i këtij promocioni, nuk është e transferueshme tek një pajisje tjetër Samsung, pra lidhet ekskluzivisht me pajisjen që është regjistruar online në mënyrën e përcaktuar sipas këtyre Kushteve.

7.Ky promocion është në dispozicion vetëm për klientët fundorë – konsumatorë (individë) dhe nuk lidhet me veprimtari, shoqëri tregtare ose persona të tjerë juridikë që i marrin këto pajisje për rishitje ose përdorim tregtar.

8.Me këtë regjistrim të pajisjes së tij me garanci "No Burn in" 10 vjeçare, klienti deklaron shprehimisht që bie dakord me këto Kushte.

"Është e nevojshme që pajisja të regjistrohet online brenda 60 ditëve nga data e blerjes e cilësuar në faturë".

DEKLARATE PËLQIMI (Shqipëri)

Duke klikuar në butonin "Regjistrohu", i jap shoqërisë tregtare Samsung Electronics Austria GmbH, degës së saj lokale dhe degëve të tyre, miratimin tim të shprehur që të dhënat e mia personale të mësipërme të grumbullohen nëpërmjet kësaj platforme elektronike dhe të përdoren prej tyre me qëllim të regjistrimit të pajisjes time të blerë, të ofrimit të shërbimit të servisit të pajisjeve gjatë periudhës së garancisë 10 vjeçare dhe të kontaktimit në lidhje me sa më lart. Jam njohur me Politikën e privatësisë së Samsung që është e disponueshme në: <https://www.samsung.com/al/privacy/> dhe jap pëlqimin tim të shprehur që të dhënat e mia personale të përdoren në përputhje me të.

Gjithashtu jam në dijeni se:

- kontrollues i të dhënave personale është Samsung Electronics Austria GmbH

- dhënia e pëlqimit tim për grumbullimin e të dhënave personale në kuadrin e promovimit është vullnetar dhe në rast se vendos të mos ndaj të dhënat e mia personale me Samsungun, nuk do të fitojë të drejtën për garanci 10-vjeçare “No Burn in”,
- menaxheri i mësipërm i koleksionit të të dhënave personale me kërkesën time do të plotësojë, ndryshojë ose fshijë të dhënat e mia personale në qoftë se ato janë të paplota, ta pasakta ose të papërditësuara dhe në qoftë se përpunimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin,
- në çdo moment mund të tërheq pëlqimin tim për mbledhjen ose për përpunimin e të dhënave të mia personale duke kontaktuar Samsung Electronics Austria GmbH, nëpërmjet të dhënave në faqen e internetit: <https://www.samsung.com/al/privacy/>
- baza ligjore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të mia personale është ushtrimi i të drejtës për 10 vjet garanci “No Burn in”,
- të dhënat e mia personale do të ruhen për kohëzgjatjen prej 10 vjetësh, pra deri në skadimin e garancisë 10 vjeçare,
- akseson të dhënat e mia personale me qëllim të përpunimit të të dhënave personale dhe dërgim dokumenti për garancinë, krahas Samsung Electronics Austria GmbH
- në qoftë se konstatoj se në të dhënat e mia personale është ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, kam të drejtë në çdo moment të paraqes ankesë pranë autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale.